

“Ndikimi i Intervenimeve mbi të Mësuarit Social-Emocional në Kompetencat Social-
Emocionale, Angazhimin Akademik, Mirëqenien Psikologjike të Përgjithshme dhe Subjektive
Shkollore tek Nxënësit e Shkollave Fillore”

Tema Për Titullin:

MASTER I ARTEVE NË PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE KËSHILLIM

ADNA TOVËRLANI



Universiteti i Prishtinës

Fakulteti Filozofik

Departamenti i Psikologjisë

Programi Psikologji Shkollore dhe Këshillim

Prishinë, Korrik 2024

Mentore: Prof.Asoc.Dr Kaltrina Kelmendi

Ky hulumtim ka për qëllim të analizojë ndikimin e intervenimeve të të mësuarit social-emocional (SEL) në kompetencat social-emocionale (SEC), angazhimin akademik, mirëqenien psikologjike dhe mirëqenien subjektive shkollore të nxënësve të shkollave fillore. Më konkretisht, hulumtimi fokusohet nëse rritja e SEC përmes intervenimeve SEL i përmirëson këto variabla. Duke pasur parasysh se zhvillimi i kompetencës social-emocionale është thelbësor për suksesin dhe mirëqenien e fëmijëve dhe adoleshentëve në të ardhmen (Ashdown & Bernard, 2012), hulumtimi përpiqet që t'iu përgjigjet pyetjeve kërkimore si P1: Cili është ndikimi i intervenimeve SEL në ngritjen e kompetencave social-emocionale?; P2: Cila është ndërlidhja mes kompetencave social-emocionale, angazhimit emocional dhe sjellor të nxënësve si dhe mirëqenies psikologjike dhe mirëqenies subjektive shkollore të nxënësve?; P3: Cili është ndikimi i kompetencave social-emocionale në angazhimin emocional dhe sjellor të nxënësve si dhe në mirëqenien psikologjike dhe mirëqenien subjektive shkollore të nxënësve?; P4: Cili është dallimi në kompetencat social-emocionale tek nxënësit pjesëmarrës para dhe pas intervenimeve SEL, si dhe mes nxënësve pjesëmarrës dhe jo-pjesëmarrës të intervenimeve SEL?; P5: Cili është dallimi i nxënësve pjesëmarrës para dhe pas intervenimeve SEL si dhe mes nxënësve pjesëmarrës dhe jo-pjesëmarrës të intervenimeve SEL në angazhimin emocional, angazhimin sjellor mirëqenien psikologjike dhe mirëqenien subjektive shkollore?

Të mësuarit social-emocional është njohur gjerësisht për ndikimin e tij pozitiv në rezultatet akademike dhe psikologjike të studentëve. Programet SEL rritin ndjeshëm aftësitë sociale dhe emocionale të studentëve, të cilat nga ana e tyre çojnë në performancë më të mirë akademike dhe përmirësim të mirëqenies psikologjike (Cipriano et al., 2023). Kështu theksohet nevoja për integrimin e SEL në kurrikulat shkollore për të promovuar mirëqenien dhe

angazhimin, prandaj hulumtimi mbështetet në modelin teorik CASEL që thekson promovimin e SEC për një zhvillim holistik të nxënësve (CASEL, 2020; Jones & Bouffard, 2012). Kjo pasi që nxënësit pjesëmarrës të intervenimeve SEL tregojnë gjithashtu përfitime afatgjata si në zhvillimin social dhe emocional, ashtu edhe në angazhimin akademik dhe mirëqenien (Taylor et al., 2017). Këto gjetje ofrojnë një bazë solide për shqyrtimin e ndikimit të intervenimeve SEL në kontekstin e shkollave fillore të Kosovës.

Prandaj, hulumtimi hipotetizon se: H1: Intervenimet SEL kanë ndikim signifikant në ngritjen e kompetencave social-emocionale; H2: Ekziston ndërlidhje signifikante mes kompetencave social-emocionale, angazhimit emocional dhe sjellor si dhe mirëqenies psikologjike dhe mirëqenies subjektive shkollore; H3: Kompetencat social-emocionale kanë ndikim signifikant në angazhimin emocional dhe sjellor si dhe mirëqenies psikologjike dhe mirëqenies subjektive shkollore; H4: Nxënësit pjesëmarrës në intervenimet SEL shënojnë pikë më të larta në kompetencat social-emocionale krahasuar me matjet para intervenimeve dhe me nxënësit jo-pjesëmarrës në intervenimet SEL; H5: Nxënësit pjesëmarrës në intervenimet SEL shënojnë pikë më të larta në angazhimin emocional, angazhimin sjellor, mirëqenien psikologjike dhe në mirëqenien subjektive shkollore krahasuar me matjet para intervenimeve dhe krahasuar me nxënësit jo-pjesëmarrës në intervenimet SEL.

Hulumtimi përdori një qasje të metodave të përziera, duke kombinuar analizat sasiore dhe cilësore të të dhënave. Dizajni i hulumtimit ishte një eksperiment i vërtetë me një grup eksperimental, ku hulumtimi përfshiu një grup eksperimental (N=82) dhe një grup kontrolli (N=95) të nxënësve të moshës 10-14 vjeç nga dy shkolla fillore të klasave 6-të dhe 7-të në Podujevë, të caktuar në mënyrë të rastësishme grupore në grupet e tyre përkatëse. Të dhënat u mblodhën duke përdorur Pyetësin e Kompetencës Sociale-Emocionale (SECQ), Pyetësin

Angazhimi kundër pakënaqësisë me të nxënit (EDL), Shkallën e Mirëqenies Psikologjike Botërore të Fëmijëve (CW-PSWBS) dhe Pyetësin e mirëqenies subjektive të studentëve (SSWQ). Të dhënat sasiore nga anketimet para-pas intervenimit u analizuan me SPSS, duke përdorur teknika statistikore si MANCOVA, regresioni linear, korrelacioni dhe t-testet për të testuar hipotezat. Të dhënat cilësore nga fokus grupi u analizuan duke përdorur analizën tematike e cila ndihmoi në identifikimin e temave dhe modeleve në përgjigjet e pjesëmarrësve.

Analiza statistikore MANCOVA zbuloi se intervenimet SEL përmirësonin ndjeshëm kompetencat social-emocionale, angazhimin akademik, mirëqenien psikologjike dhe mirëqenien subjektive të shkollës në grupin eksperimental në krahasim me grupin e kontrollit. Analiza Paired Sample t-test tregoi përmirësime të rëndësishme në matjet e grupit eksperimental para dhe pas intervenimit, duke demonstruar efektivitetin e intervenimit SEL në rritjen e kompetencave dhe mirëqenies së studentëve me kalimin e kohës. Analiza independent sample t-test tregoi ndryshime signifikante midis rezultateve të grupeve eksperimentale dhe atyre të kontrollit pas intervenimit, duke theksuar ndikimin pozitiv të programeve SEL në rezultatet social-emocionale dhe akademike të studentëve.

Më tutje, diskutimet në fokus grup dhanë njohuri shtesë mbi përvojat e studentëve me intervenimin SEL. Nxënësit raportuan se ndiheshin më të vetëdijshëm emocionalisht dhe ishin më të gatshëm në njohjen e emocioneve të tjerëve (njohja më e mirë e vetes dhe tjerëve), treguan se ishin më të aftë në mënyrë shoqërore (përmirësimi i marrëdhënieve dhe njohurive mbi zgjidhjen e problemeve), më të motivuar për të ardhur në shkollë (angazhimi akademik) si dhe ndiheshin në përgjithësi më mirë (mirëqenia e përgjithshme) pasi morën pjesë në aktivitetet SEL, gjë e cila mbështet më tutje të gjeturat kuantitative mbi efektivitetin e intervenimit SEL duke

nënvizuar rëndësinë e programeve SEL në nxitjen e një mjedisi mësimor mbështetës dhe të favorshëm.

Gjetjet e hulumtimit, përputhen me kërkimet e mëparshme që nënvizojnë ndikimin pozitiv të intervenimeve SEL në kompetencat social-emocionale, angazhimin akademik dhe mirëqenien e studentëve (Kander et al., 2024; Shi et al., 2022; Chen & Yu, 2022). Përmirësimet e rëndësishme të vërejtura në grupin eksperimental sugjerojnë që programet SEL përmirësojnë në mënyrë efektive aftësitë emocionale dhe sociale të studentëve, duke çuar në performancë më të mirë akademike dhe mirëqenie psikologjike. Të dhënat cilësore mbështesin më tej këto rezultate, duke ofruar një kuptim më të thellë të përvojave subjektive të studentëve dhe përfitimeve të perceptuara të intervenimeve të SEL.

Teorikisht, këto rezultate përforcojnë rëndësinë e integritit të programeve SEL brenda kurrikulës arsimore, duke u përafuar me kornizën teorike CASEL që theksonë zhvillimin holistik të studentëve. Praktikisht, studimi sugjeron që shkollat duhet t'i japin përparësi intervenimeve SEL për të nxitur një mjedis mësimor mbështetës dhe tërheqës, i cili mund të çojë në rezultate të përmirësuara të nxënësve si në fushën akademike ashtu edhe në atë emocionale. Megjithatë, studimi ka kufizime, duke përfshirë kohëzgjatjen relativisht të shkurtër të intervenimit dy javor si dhe mungesën e ndjekjes afatgjatë për të vlerësuar efektet e qëndrueshme. Hulumtimet e ardhshme duhet t'i adresojnë këto kufizime duke zbatuar studime afatgjata me mostra e intervenime të ndryshme dhe duke përdorur metoda të përziera për të kapur një pamje më gjithëpërfshirëse të ndikimit të SEL. Për më tepër, inkorporimi i matjeve folloë-up dhe vlerësimeve cilësore si intervistat mund të ofrojë njohuri më të thella mbi efektet dhe mekanizmat afatgjatë të intervenimeve SEL, duke i udhëhequr edukatorët dhe politikëbërësit në krijimin e programeve më efektive dhe të qëndrueshme.